

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

# **RAPORTI I VEPRIMTARISË AKADEMIKE, KËRKIMORE-SHKENCORE DHE FINANCIARE PËR VITIN 2016**

Miratuar me Vendimin nr. 17, datë 24.02.2017, të Senatit Akademik të  
Universitetit të Mjekësisë, Tiranë

**Tiranë, 2017**

## Përmbajtja

<b>Hyrje.....</b>	<b>3</b>
<b>I. Veprimtaria akademike.....</b>	<b>7</b>
1. Programet e studimit.....	7
2. Personeli akademik.....	8
3. Studentët.....	16
4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit.....	17
<b>II. Veprimtaria kërkimore-shkencore.....</b>	<b>19</b>
1. Aktivitetet shkencore në rang universiteti.....	19
2. Aktivitetet shkencore në nivel fakulteti.....	21
3. Marrëveshjet e nënshkuara në vitin 2016.....	29
4. Pjesëmarrja në rrjetet akademike.....	31
5. Njohjet ndërkombëtare institucionale të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.....	32
<b>III. Veprimtaria financiare.....</b>	<b>33</b>
1. Realizimi faktik vjetor i shpenzimeve me financim nga fondet buxhetore.....	34
2. Realizimi faktik vjetor i shpenzimeve me financim nga të ardhurat.....	35
3. Realizimi i të ardhurave.....	37

## HYRJE

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, (UMT) mbart traditën historike 65-vjeçare të formimit universitar publik të shkencave mjekësore në Republikën e Shqipërisë. Ai ofron ekspertizën profesionale në arsimimin dhe përgatitjen shkencore të specialistëve të shëndetit. Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, ka në përbërjen e tij një staf akademik ndër më elitarët në vend, ku bashkërendohet përvoja e një brezi të tërë mjekësh dhe profesionistësh të shëndetit. Të gjithë pedagogët e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, janë të specializuar në fushat e tyre të ekspertizës dhe kanë kryer trajnime dhe bashkëpunime të shumta shkencore në universitetet e njohura evropiane dhe amerikane. Stafi akademik është i dedikuar ndaj studentëve, për të ofruar të gjithë përvojën e tij në përparimin e dijes dhe shkencës. Angazhimi i tyre dhe i të gjitha strukturave të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, ka sjellë një rritje të ndjeshme të cilësisë së mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor dhe, në këtë kuadër, janë shtuar bashkëpunimet ndërkombëtare në projekte me partnerë prestigjiozë, që e pasurojnë akoma më shumë këtë proces zhvillimi në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.

Ky raport është bazuar në raportet vjetore të njësive kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, përkatësisht:

- Raportin vjetor mësimor, kërkimor-shkencor dhe financiar, të Fakultetit të Mjekësisë, me Nr. 2016/1 Prot., datë 09.02.2017;
- Raportin vjetor mësimor, kërkimor-shkencor dhe financiar, të Fakultetit të Mjekësisë Dentare, me Nr. 32/1 Prot., datë 06.02.2017;
- Raportin vjetor mësimor, kërkimor-shkencor dhe financiar, të Fakultetit të Shkencave Teknike Mjekësore, me Nr. 64/1 Prot., datë 06.02.2017;

si dhe në anketimet e realizuara me stafin akademik dhe studentët për aspekte kryesore të universitetit dhe analizat e tjera specifike/krahasimore të kryera gjatë këtij viti.

Në vitin 2016, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, janë angazhuar në procesin e mësimdhënies 778 pedagogë, nga të cilët 292 janë personel akademik me kohë të plotë, 159 personel akademik i strukturave shëndetësore universitare dhe 327 personel akademik me kohë të pjesshme; 57 personel ndihmësakademik, nga të cilët 29 me kohë të plotë; 120 personel

administrativ, nga të cilët 81 me kohë të plotë. Përsa i përket kualifikimit shkencor të personelit akademik, nga 292 punonjës me kohë të plotë, 251 prej tyre, pra rreth 90%, kanë tituj akademikë dhe grada shkencore.

Numri i studentëve që ndjekin studimet në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, në të gjitha ciklet e studimit, duke përfshirë dhe pranimet në vitin akademik 2016-2017, është rreth 7852 studentë (kjo e dhënë i referohet muajit dhjetor të vitit 2016).

### **Programet e studimit që ofron Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, janë si më poshtë:**

- **Fakulteti i Mjekësisë**

<b>Nr.</b>	<b>CIKLI I STUDIMIT</b>	<b>PROGRAMI I STUDIMIT</b>
1	Program i ciklit të parë të studimeve "Bachelor"	Shëndet Publik
2	Program i ciklit të dytë të studimeve "Master Profesional"	Shëndet Publik
3	Program i ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave"	Shëndet Publik
4	Program i integruar i ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave"	Mjekësi e Përgjithshme
5	Program i integruar i ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave"	Farmaci
6	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Mjekësi Urgjence
7	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Neurokirurgji
8	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Mjekësi Interne
9	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Mjekësi Transfuzive
10	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Alergologji
11	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Anatomi Patologjike
12	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Anestezia-Reanimacion
13	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Dermatologji
14	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Endokrinologji
15	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Gastrohepatologji
16	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Hematologji
17	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Diagnozë me Imazhe
18	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Kardiokirurgji
19	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Kardiologji
20	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Kirurgji e Përgjithshme
21	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Laborator Klinik - Biokimik
22	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Mikrobiologji
23	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Mjek Familje
24	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Mjekësi Ligjore
25	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Nefrologji
26	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Neurologji
27	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	ORL
28	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Obstetrikë - Gjinekologji
29	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Okulistikë
30	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Onkologji

31	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Ortopedi - Traumatologji
32	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Pediatri
33	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Pneumatologji
34	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Psikiatri
35	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Psikiatri e Fëmijëve dhe e Adoleshentëve
36	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Reumatologji
37	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Sëmundje Infektive
38	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Shëndet Publik
39	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Toksikologji Klinike
40	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Studime të Thelluara, në Farmakologji, Fiziologji, Fiziologji Patologjike
41	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Studime të Thelluara të Aspekteve Epidemiologjike, Diagnostike dhe Terapeutike të Sëmundjeve Infektive Emergjente dhe Riemergjente në Shqipëri
42	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Shëndet Publik
43	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Studime të Thelluara të Aspekteve Epidemiologjike, Diagnostike dhe Terapeutike të Sëmundjeve të Lëkurës
44	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Studime të Thelluara dhe Kërkime në Otorinolaringologji
45	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Studime të Thelluara në Kardiologji
46	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Studime në Neuroshkencë
47	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Studime në Obstetrikë - Gjinekologji
48	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Studime në Mjekësi Laboratorike
49	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Morfologji Klinike
50	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Sëmundjet Kirurgjikale
51	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Imazheri
52	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Anatomi Patologjike dhe Mjekësi Ligjore
53	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Sëmundjet e Syrit
54	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Pediatri
55	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Sëmundjet e Brendshme
56	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Shkencat Farmaceutike
57	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Kardiologji Kirurgji

• **Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike**

<b>Nr.</b>	<b>CIKLI I STUDIMIT</b>	<b>PROGRAMI I STUDIMIT</b>
1	Program i ciklit të parë të studimeve "Bachelor"	Infermieri e Përgjithshme
2	Program i ciklit të parë të studimeve "Bachelor"	Mami
3	Program i ciklit të parë të studimeve "Bachelor"	Teknikë Laboratori
4	Program i ciklit të parë të studimeve "Bachelor"	Logopedi
5	Program i ciklit të parë të studimeve "Bachelor"	Imazheri
6	Program i ciklit të parë të studimeve "Bachelor"	Fizioterapi
7	Program i studimit të ciklit të dytë të studimeve "Master Profesional"	Menaxhim Infermieror
8	Program i studimit të ciklit të dytë të studimeve "Master Profesional"	Mami
9	Program i studimit të ciklit të dytë të studimeve "Master Profesional"	Teknikë Laboratori

10	Program i studimit të ciklit të dytë të studimeve "Master Profesional"	Logopedi
11	Program i studimit të ciklit të dytë të studimeve "Master Profesional"	Geriatri
12	Program i studimit të ciklit të dytë të studimeve "Master Profesional"	Teknikë Imazherie
13	Program i studimit të ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave"	Infermieri
14	Program i studimit të ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave"	Teknikë Laboratori
15	Program i studimit të ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave"	Fizioterapi
16	Program i studimit të ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave"	Teknikë Imazherie
17	Program i studimit të ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave"	Mami
18	Program i studimit të ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave"	Logopedi
19	Program i ciklit të tretë të studimeve të studimeve "Doktoratë"	Lëndët Klinike
20	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Lëndët Paraklinike
21	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Shkenca Infermierore, me profil Infermieri
22	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Shkenca Infermierore, me profil Mami
23	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Shkenca Infermierore, me profil Fizioterapi
24	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Shkenca Infermierore, me profil Logopedi
25	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Shkenca Infermierore, me profil Teknikë Laboratori
26	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Shkenca Infermierore, me profil Teknikë Imazherie

• **Fakulteti i Mjekësisë Dentare**

Nr.	CIKLI I STUDIMIT	PROGRAMI I STUDIMIT
1	Program i integruar i ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave"	Stomatologji
2	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Kirurgji Oro-Maksilo Faciale
3	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Pedodonti
4	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Terapi Stomatologjike
5	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Studime në Patologji Oro-Maxilo-Faciale

## **I. VEPRIMTARIA AKADEMIKE**

Viti 2016, përveç të qenit një vit zgjedhor për të gjitha autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet e arsimit të lartë, solli edhe riorganizimin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për sa i përket numrit të njësive kryesore dhe departamenteve, ku sipas Urdhrit Nr. 151, datë 30.03.2016, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, në përbërje të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, janë 3 (tri) njësi kryesore dhe 22 departamente, të cilat janë konsoliduar tashmë me staf akademik dhe administrativ.

### **1. Programet e studimit**

Oferta akademike e programeve të studimit në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, tashmë e konsoliduar, bazuar në procesin e Bolonjës, u jep mundësi studentëve për studime të mëtejshme e në vijimësi, përkatësisht:

- pas përfundimit të ciklit të parë të studimeve “Bachelor”, studentët kanë mundësinë të vazhdojnë studimet e tyre në programet e ciklit të dytë të studimeve “Master Profesional” ose “Master i Shkencave” dhe, më tej, në ciklin e tretë të studimeve “Doktoratë”;
- pas përfundimit të një programi të integruar të ciklit të dytë të studimeve, studentët kanë të drejtë të vazhdojnë një program të ciklit të tretë të studimeve “Doktoratë” ose “Specializim Afatgjatë”.

Programet e aktivizuara për vitin akademik 2016-2017 në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, janë:

- 6 programe të ciklit të parë të studimeve “Bachelor”;
- 7 programe të ciklit të dytë të studimeve “Master Profesional”;
- 7 programe të ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave”;
- 3 programe të integruara të ciklit të dytë të studimeve;
- 28 programe të ciklit të tretë të studimeve “Specializim Afatgjatë”

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, duke u bazuar dhe në planin e zhvillimit strategjik të tij dhe në përputhje me nevojat e tregut të punës, ka hartuar dhe aplikuar pranë organeve përkatëse për hapjen e programeve të reja të studimit (“Master Profesional në Menaxhim Shëndetësor” dhe “Specializim Afatgjatë në Kirurgji Plastike, Rekonstruktive dhe Djegie”), si dhe ka rishikuar kurrikulat ekzistuese që ofron aktualisht ky universitet.

Në zbatim të legjislacionit në fuqi, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, ka përcaktuar dhe ka bërë publike kriteret përzgjedhëse të pranimit për vitin akademik 2016-2017, në të gjitha programet e studimit (Cikli I+II+III), me vendimet përkatëse të Senatit Akademik. Vlen të theksohet fakti që universiteti ynë është i vetmi institucion që ka vendosur si kriter pranimi notën mesatare mbi 8 për programet e ciklit të parë dhe mbi 8.5 për programet e integruara të ciklit të dytë.

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, aktualisht menaxhon procesin e pranimeve në specializimet afatgjata, në zbatim të Rregullores së Studimeve të Specializimeve Afatgjata, të Ciklit të Tretë, në Fushën e Mjekësisë, të miratuar me Vendimin Nr. 88, datë 16.11.2016, të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, si dhe Udhëzimit Nr. 62, datë 01.12.2016, i ndryshuar.

## **2. Personeli akademik**

Në vitin akademik 2015-2016, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, kanë kontribuar në mësimdhënie gjithsej 778 punonjës si personel akademik.

Në mbështetje të Ligjit Nr.80/2015, datë 22.07.2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*, neni 57 *“Personeli i institucioneve të arsimit të lartë”*, pika 1 *“Personeli i institucioneve të arsimit të lartë përbëhet nga personeli akademik, personeli ndihmësakademik dhe personeli administrativ”*, pika 2 *“Personeli i institucioneve të arsimit të lartë mund të jetë i punësuar me kontratë, me kohëzgjatje të pacaktuar ose të caktuar, si edhe me angazhim me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme”*, neni 25 *“Departamenti”*, pika 6 *“Në institucionet e arsimit të lartë publik, që kanë struktura shëndetësore universitare, departamentet përbëhen nga shërbimet, të cilat formohen në bazë të specialitetit”* dhe neni 28 *“Strukturat shëndetësore universitare”*, ku cilësohet *“Strukturat shëndetësore universitare janë njësi të sistemit arsimor dhe të sistemit shëndetësor, të cilat realizojnë shërbime terciare, funksione diagnostikuese e trajtuese, si dhe funksione mësimore e kërkimore-shkencore, si pjesë e institucionit të arsimit të lartë...”*, kategoritë e personelit akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, janë:

1. personel akademik me kohë të plotë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë;
2. personel akademik me kohë të pjesshme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, dhe punonjës me kohë të plotë në strukturat shëndetësore universitare;
3. personel akademik me kohë të pjesshme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.




Një përqindje e konsiderueshme e personelit akademik me kohë të pjesshme, i cili është i angazhuar në mësimdhënie në fakultetet e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, është pjesë e stafit mjekësor të strukturave shëndetësore universitare, si Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, Spitali Obstetrik-Gjinekologjik “Koço Gliozheni”, Spitali Universitar i Traumës etj.

Sipas kategorizimit të mësipërm, nga 778 punonjës të personelit akademik:

- 292 janë personel akademik me kohë të plotë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë;
  - 159 janë personel akademik me kohë të pjesshme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë dhe punonjës me kohë të plotë në strukturat shëndetësore universitare;
  - 327 janë personel akademik me kohë të pjesshme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.
- *Analiza e raporteve numerike të personelit akademik me kohë të plotë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2015-2016*

NUMRI TOTAL I PERSONELITAKADEMIK ME KOHË TË PLOTË NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, VITI 2015-2016 (FAKTIK)		
Nr.	Fakulteti	Numri i pedagogëve
1	Fakulteti i Mjekësisë	203
2	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	66
3	Fakulteti i Mjekësisë Dentare	23
<b>TOTAL PËR KATEGORI</b>		<b>292</b>

Tabela 2.1 Numri i personelit akademik me kohë të plotë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë



Grafiku 2.1 Numri i personelit akademik me kohë të plotë (në përqindje) në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë

Në fund të vitit 2016:

- Fakulteti i Mjekësisë ka pasur 203 pedagogë, ose 69% të numrit total të personelit akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike ka pasur 66 pedagogë, ose 23% të numrit total të personelit akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.
- Fakulteti i Mjekësisë Dentare ka pasur 23 pedagogë, ose 8% të numrit total të personelit akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.

Siç shihet nga të dhënat e mësipërme, Fakulteti i Mjekësisë ka pasur numrin më të lartë të personelit akademik me kohë të plotë të angazhuar në vitin akademik 2015-2016.

- ***Analiza e raporteve numerike të personelit akademik me kohë të pjesshme në Universitetin e Mjekësisë dhe me kohë plotë në strukturat shëndetësore universitare, si dhe i personelit akademik me kohë të pjesshme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë***

Për zhvillimin e procesit mësimor në vitin akademik 2015-2016 janë aktivizuar në total 486 punonjës staf akademik me kohë të pjesshme, 159 prej të cilëve janë staf me kohë të plotë në strukturat shëndetësore universitare (SSHU), ndërsa 357 punonjës janë personel akademik me kohë të pjesshme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.

Ky kategorizim i personelit akademik me kohë të pjesshme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2015-2016, paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Siç shihet, për vitin akademik 2015-2016 në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë janë angazhuar në total 486 punonjës me kohë të pjesshme, përkatësisht 211 në Fakultetin e Mjekësisë, 208 në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike dhe 67 në Fakultetin e Mjekësisë Dentare.

<b>NUMRI TOTAL I PERSONELIT AKADEMIK ME KOHË TË PJESSHME NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, VITI AKADEMIK 2015-2016</b>				
<b>Nr.</b>	<b>Fakulteti</b>	<b>Të jashtëm</b>	<b>SSHU</b>	<b>Total</b>
<b>1</b>	Fakulteti i Mjekësisë	144	67	211
<b>2</b>	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	141	67	208
<b>3</b>	Fakulteti i Mjekësisë Dentare	42	25	67
<b>TOTAL</b>		<b>327</b>	<b>159</b>	<b>486</b>

*Tabela 2.2 Numri total i personelit akademik me kohë të pjesshme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë*



Grafiku 2.2 Personeli akademik me kohë të pjesshme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, pjesë e strukturave shëndetësore universitare dhe jashtë tyre

Siç shihet dhe nga grafiku, në secilin fakultet të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, stafi akademik me kohë të pjesshme është i përbërë edhe nga stafi i angazhuar si mjek në strukturat shëndetësore universitare, të cilët kontribuojnë në mësimdhënie dhe në zhvillimin e procesit mësimor. Fakulteti i Mjekësisë ka numrin me të lartë të personelit akademik me kohë të pjesshme të angazhuar në vitin akademik 2015-2016.

<b><u>NUMRI TOTAL I PERSONELITAKADEMIK NË STRUKTURAT SHËNDETËSORE UNIVERSITARE, VITI AKADEMIK 2015-2016</u></b>				
<b>Nr.</b>	<b>Fakulteti</b>	<b>UMT</b>	<b>SSHU</b>	<b>Total</b>
<b>1</b>	Fakulteti i Mjekësisë	203	67	<b>270</b>
<b>2</b>	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	66	67	<b>133</b>
<b>3</b>	Fakulteti i Mjekësisë Dentare	23	25	<b>48</b>
<b>TOTAL</b>		<b>292</b>	<b>159</b>	<b>451</b>

Tabela 2.3 Numri total i personelit akademik në strukturat shëndetësore universitare



Grafiku 2.3. Personeli akademik i strukturave shëndetësore universitare (%) në raport me personelin akademik jashtë SSHU-së

Në tabelën 2.3 është paraqitur numri total i personelit akademik në strukturat shëndetësore universitare, ndërsa në grafikun 2.3 është paraqitur raporti personel akademik në strukturat shëndetësore universitare (SSHU) me personelin akademik jashtë SSHU-së. Siç shihet, 58% e

personelit akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, është pjesë e strukturave shëndetësore universitare (SSHU), ndërsa 42% është personel akademik jashtë SSHU.

- **Analiza numerike e titujve akademikë dhe gradave shkencore të personelit akademik me kohë të plotë**

Në tabelën e mëposhtme paraqitet personeli akademik me kohë të plotë për vitin akademik 2015-2016, i shpërndarë sipas titujve akademikë dhe gradave shkencore në secilin fakultet.

<b>PERSONELI AKADEMIK SIPAS TITUJVE AKADEMIKË/GRADAVE SHKENCORE, VITI AKADEMIK 2015-2016</b>						
<b>Nr.</b>	<b>Fakulteti</b>	<b>Profesor</b>	<b>Prof. Asc.</b>	<b>Dr.</b>	<b>Lektor</b>	<b>Total</b>
<b>1</b>	Fakulteti i Mjekësisë	92	60	40	11	<b>203</b>
<b>2</b>	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	2	6	30	28	<b>66</b>
<b>3</b>	Fakulteti i Mjekësisë Dentare	6	6	9	2	<b>23</b>
		<b>100</b>	<b>72</b>	<b>79</b>	<b>41</b>	<b>292</b>

Tabela 2.4 Shpërndarja e personelit akademik me kohë të plotë sipas titujve akademikë/gradave shkencore

Siç shihet nga të dhënat, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, nga 292 punonjës personel akademik me kohë të plotë në total, 251 janë me tituj akademikë dhe grada shkencore, të ndarë përkatësisht: 192 punonjës personel akademik në Fakultetin e Mjekësisë, 38 në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike dhe 21 në Fakultetin e Mjekësisë Dentare.


**PERSONELI AKADEMIK SIPAS TITUJVE AKADEMIKË/GRADAVE SHKENCORE, VITI AKADEMIK 2015-2016 NË UMT**



Grafiku 2.4 Shpërndarja e personelit akademik me kohë të plotë (në përqindje) sipas titujve akademikë/gradave shkencore

Në grafikun e mësipërm është paraqitur shpërndarja e personelit akademik me kohë të plotë (në përqindje) sipas titujve akademikë dhe gradave shkencore në Universitetin e Mjekësisë,

Tiranë. Në grafikun 2.4 vihet re se 34% e personelit akademik kanë titullin akademik “Profesor”, 25% “Profesor i Asociuar”, 27 % kanë gradën shkencore “Doktor” dhe 14% janë “Lektorë”. Sipas këtyre të dhënave, 86% e personelit akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, janë me tituj akademikë dhe grada shkencore.



Grafiku 2.5 Shpërndarja e stafit akademik me kohë të plotë sipas titujve akademikë/gradave shkencore sipas fakulteteve.

Në grafikun 2.5 paraqitet shpërndarja e personelit akademik me kohë të plotë sipas titujve akademikë/gradave shkencore në secilin fakultet. Siç shihet, në Fakultetin e Mjekësisë, nga një numër total prej 203 pedagogësh në vitin 2016, 92 prej tyre mbajnë titullin “Profesor”, 60 “Profesor i Asociuar”, 40 kanë gradën shkencore “Doktor” dhe 11 janë “Lektorë”. Në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, nga 66 pedagogë në vitin 2016, 2 prej tyre mbajnë titullin “Profesor”, 6 “Profesor i Asociuar”, 30 kanë gradën shkencore “Doktor” dhe 28 janë “Lektorë”. Në Fakultetin e Mjekësisë Dentare, nga 23 pedagogë në total në vitin 2016, 6 prej tyre mbajnë titullin “Profesor”, 6 “Profesor i Asociuar”, 9 kanë gradën shkencore “Doktor” dhe 2 janë “Lektorë”.

Sipas të dhënave, Fakulteti i Mjekësisë ka numrin më të lartë të personelit akademik në numër si dhe në tituj akademikë dhe grada shkencore.

▪ ***Analiza e rritjes së numrit të personelit akademik nga viti akademik 2012-2013 në vitin akademik 2015-2016 dhe ndryshimet në titujt akademikë dhe gradat shkencore***

Në tabelën 2.5 është paraqitur personeli akademik me kohë të plotë i angazhuar në procesin mësimor në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, në vitin akademik 2012-2013, sipas titujve akademikë dhe gradave shkencore për secilin fakultet, ku vihet re se janë angazhuar në total 287 punonjës akademikë me kohë të plotë, përkatësisht 202 në Fakultetin e Mjekësisë, 67 në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike dhe 18 në Fakultetin e Mjekësisë Dentare. Gjithashtu, me qëllim krahasimin e numrit të stafit akademik, në tabelën 2.6 paraqitet numri i


personelit akademik me kohë të plotë në vitin akademik 2015-2016.

PERSONELI AKADEMIK SIPAS TITUJVE AKADEMIKË/GRADAVE SHKENCORE, VITI AKADEMIK 2012-2013						
Nr.	Fakulteti	Profesor	Prof. Asc.	Dr.	Lektor	Total
1	Fakulteti i Mjekësisë	59	52	62	29	202
2	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	1	3	4	59	67
3	Fakulteti i Mjekësisë Dentare	4	4	6	4	18
		<b>64</b>	<b>59</b>	<b>72</b>	<b>92</b>	<b>287</b>

Tabela 2.5 Shpërndarja e stafit akademik me kohë të plotë sipas titujve akademikë/gradave shkencore në vitin akademik 2012-2013

PERSONELI AKADEMIK SIPAS TITUJVE AKADEMIKË/GRADAVE SHKENCORE, VITI AKADEMIK 2015-2016						
Nr.	Fakulteti	Profesor	Prof. Asc.	Dr.	Lektor	Total
1	Fakulteti i Mjekësisë	92	60	40	11	203
2	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	2	6	30	28	66
3	Fakulteti i Mjekësisë Dentare	6	6	9	2	23
		<b>100</b>	<b>72</b>	<b>79</b>	<b>41</b>	<b>292</b>

Tabela 2.6 Shpërndarja e stafit akademik me kohë të plotë sipas titujve akademikë/gradave shkencore në vitin akademik 2015-2016



Grafiku 2.6 Krahasimi i rritjes së numrit të pedagogëve nga viti akademik 2012-2013 në vitin akademik 2015-2016 dhe ndryshimet në titujt akademikë dhe gradat shkencore

Siç shihet nga të dhënat e tabelave, numri i punonjësve faktikë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, është rritur me 2%, nga 287 në 292 punonjës. Përsa i përket titujve akademikë dhe gradave shkencore ka pasur këto ndryshime:

- Personeli akademik me titull “Profesor” është rritur nga 64 në 100 punonjës, ose 56%.
- Personeli akademik me titull “Profesor i Asociuar” është rritur nga 59 në 72 punonjës,

ose 22%.

- Personeli akademik me gradën shkencore “Doktor” është rritur nga 72 në 79 punonjës, ose 10%.
- Personeli akademik “Lektor” është ulur nga 92 në 41 punonjës, ose 55%.

- *Analiza e numrit të studentëve në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, në raport me numrin e pedagogëve, për vitin akademik 2015-2016*

<b><u>NUMRI TOTAL I STUDENTËVE NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, VITI AKADEMIK 2015-2016</u></b>		
<b>Nr.</b>	<b>Programi i studimit</b>	<b>Numri i studentëve</b>
1	Bachelor	2530
2	Bachelor (sistemi me kohë të pjesshme)	413
3	PIND	3457
4	Master Profesional	615
	Master i Shkencave	622
5	Specializim Afatgjatë	414
6	Doktoraturë	604
	<b>TOTAL</b>	<b>8655</b>

*Tabela 2.7 Numri total i studentëve sipas programeve të studimit, për vitin akademik 2015-2016*

<b><u>NUMRI TOTAL I STUDENTËVE NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, VITI AKADEMIK 2015-2016</u></b>		
<b>Nr.</b>	<b>Fakulteti</b>	<b>Numri i studentëve</b>
1	Fakulteti i Mjekësisë	3802
2	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	4141
3	Fakulteti i Mjekësisë Dentare	712
	<b>TOTAL</b>	<b>8655</b>

*Tabela 2.8 Numri total i studentëve sipas fakulteteve, për vitin akademik 2015-2016*

Në tabelën 2.6 është paraqitur numri total i studentëve në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2015-2016, sipas programeve të studimit, ndërsa në tabelën 2.7 është paraqitur numri total i studentëve në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2015-2016, për secilin fakultet.

<b><u>RAPORTI PERSONEL AKADEMIK/STUDENT NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË TIRANË, PËR VITIN AKADEMIK 2015-2016</u></b>				
<b>Nr.</b>	<b>FAKULTETI</b>	<b>NR. TOTAL I PERSONELIT</b>	<b>NR. TOTAL I STUDENTËVE</b>	<b>RAPORTI</b>

		AKADEMIK		
1	Fakulteti i Mjekësisë	414	3802	9.18
2	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	274	4141	15.11
3	Fakulteti i Mjekësisë Dentare	90	712	7.91
<b>TOTAL PËR KATEGORI</b>		<b>778</b>	<b>8655</b>	<b>11.12</b>

Tabela 2.9 Raporti pedagog/student për vitin akademik 2015-2016

Në tabelën 2.8 është përlogaritur raporti pedagog/student në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, i cili është 11 studentë për një pedagog. Fakulteti i Mjekësisë Dentare ka raportin më të ulët, me 7.9 studentë për pedagog, ndërsa raportin më të lartë e ka Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, me 15 studentë për pedagog. Fakulteti i Mjekësisë ka një raport prej 9 studentësh për pedagog.


### 3. Studentët

Shpërndarja e studentëve sipas njësive kryesore (fakulteteve) të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, duke përfshirë këtu edhe studentët e regjistruar në vitin akademik 2016-2017 dhe që ndjekin aktualisht studimet, paraqitet si më poshtë:

Nr.	Fakulteti	Bsc	MP	Msc	PICD	Doktoratë	Specializim Afatgjatë	Totali
1	Fakulteti i Mjekësisë	13	130	73	2680	270	568	3734
2	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	1828	567	585	-	153	-	3133
3	Fakulteti i Mjekësisë Dentare		-	-	668	27	20	715
<b>Totali</b>		1841	697	658	3348	450	588	7582

Tabela 3.1 Shpërndarja e studentëve në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, sipas njësive kryesore





Grafiku 3.1 Shpërndarja e studentëve në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, sipas njësive kryesore

Siç shihet dhe nga grafiku:

- Në programet e ciklit të parë dhe programet e integruara të ciklit të dytë (Mjekësi, Farmaci, Stomatologji), studiojnë aktualisht rreth 68.5% e studentëve, nga të cilët 24.2% në Bsc dhe 44.3% në PICD.
- Në programet “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” studiojnë aktualisht 18% e studentëve, nga të cilët 9.2% në “Master Profesional” dhe 8.8% në ciklin e dytë “Master i Shkencave”.
- Në programet e ciklit të tretë janë aktualisht 13.5% e studentëve, nga të cilët 5.7% janë në proces doktore, ndërsa 7.8% e studentëve ndjekin studimet në programet e ciklit të tretë specializim afatgjatë në fushën e mjekësisë.

Kalueshmëria në nivel universiteti, sipas të dhënave nga njësitet kryesore, rezulton të jetë mesatarisht 61.4%.

Në vitin akademik 2016-2017, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, kanë filluar për herë të parë studimet 1 558 studentë, të ndarë përkatësisht:

- 366 studentë në ciklin e parë të studimeve (Bsc);
- 377 studentë në programet e integruara të ciklit të dytë (PICD);
- 629 studentë në ciklin e dytë Master Profesional (MP) dhe Master i Shkencave (Msc);
- 186<sup>1</sup> studente në programet e ciklit të tretë Specializim Afatgjatë (SPA)

Pranimet e studentëve në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2016-2017, në

<sup>1</sup> Procesi i regjistrimit të kandidatëve për specializantë përfundon në muajin shkurt 2017

të gjitha programet e studimit, janë bërë në përputhje me kriteret dhe kuota e miratuara me Vendim të Senatit Akademik të UMT-së, sipas standardeve shtetërore të kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore.

#### **4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit**

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, ka në dispozicion të procesit mësimor një sipërfaqe totale prej 77.698 m<sup>2</sup>, ku janë përfshirë dhe ambientet e strukturave shëndetësore universitare (Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, Klinika Universitare Stomatologjike, Spitali Universitar i Traumës, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, Spitali Obstetrik-Gjinekologjik Nr.1 dhe Spitali Obstetrik-Gjinekologjik Nr.2).

Nga anketimet e bëra në lidhje me infrastrukturën dhe nga analiza e rezultateve është hartuar planveprimi për përmirësimin e kushteve të auditorëve (leksione/seminare) dhe për pajisjen me mjete bashkëkohore të laboratorëve, kryesisht për programin “Master i Shkencave” në Mjekësi të Përgjithshme.

## II. VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE

Veprimtaria kërkimore-shkencore është një ndër shtyllat kryesore ku mbështetet plani i zhvillimit strategjik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, dhe përbën bazën e balancimit të dijeve teorike me ato praktike. Zhvillimi i kërkimit shkencor vijon paralelisht me aktivitetin e mësimdhënies dhe, së bashku, janë motorët e mirëfilltë të njohjes kritike, krijimtarisë, inovacionit dhe cilësisë në universitetin tonë. Në këtë kuadër, aktiviteti i kërkimit shkencor realizohet përmes organizimit të konferencave shkencore në nivel fakulteti dhe universiteti, me anë të pjesëmarrjes në projektet e programeve evropiane si “Erasmus+” dhe “Horizon2020”, angazhimeve në grupet e punës shkencore në fushat më të rëndësishme të studimeve mjekësore, duke përfaqësuar universitetin dhe vendin në rang kombëtar dhe ndërkombëtar, hulumtimeve dhe publikimeve të artikujve shkencorë në Revistën Shkencore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë “*Albanian Journal of Medical and Health Sciences (AJMHS)* (ISSN 2412-6373 dhe E-ISSN 2413-3892)” dhe revistat shkencore të fakulteteve, si “*Revista Stomatologjike Shqiptare*” (organ i Fakultetit të Mjekësisë Dentare) dhe Revista “*Mjekësia Bashkëkohore*” (organ i Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike), si dhe përmes punës individuale shkencore të stafit akademik në departamente.

Gjatë vitit 2016, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është angazhuar në drejtim të zhvillimit të aktiviteteve të shumta shkencore, me synimin e qartë për të promovuar punën kërkimore dhe dijet e reja të prodhuara me cilësi dhe standarde të larta nga stafi i tij akademik. Ndër aktivitetet e organizuara përfshihen kongreset, konferencat, simpoziumet dhe grupet e punës kërkimore, me pjesëmarrje nga vendi dhe ndërkombëtare. Në krahasim me vitin akademik paraardhës, kongreset, konferencat dhe simpoziumet janë shtuar ndjeshëm dhe janë kthyer në një traditë

pune, duke rritur cilësinë dhe njohjen ndërkombëtare të universitetit, përmes tërheqjes gjithnjë e më tepër të personaliteteve shkencore ndërkombëtare me në zë nga universitetet më prestigjioze evropiane, të cilët kanë bashkëpunuar në shumë grupe pune në kuadër të zbatimit të projekteve ndërkombëtare të fituara nga njësitë e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

### 1. Aktivitetet shkencore në rang universiteti

Nr.	Titulli i konferencës	Data e zhvillimit
1.	Premiera e Bioetikës Shqiptare	19.10.2016
2.	Konferenca Kombëtare e Shkencave Mjekësore 3	8-10.04.2016

Tabela 1.1. Konferencat shkencore të realizuara në rang universiteti

Nr.	Emri i projektit	Programi	Institucioni koordinator	Periudha e projektit	Status i
1	<b>GRADUA</b> (Graduates Advancement and Development of University capacities in Albania)	Erasmus+ Capacity Building in the Field of Higher Education (Key Action 2: Cooperation for innovation and the exchange of good practices, Capacity-building in higher education)	AlmaLaurea Consortium, në Itali	Periudha e aplikimit: 2016	Në proces
2	<b>ENSPED</b> (Enhancement of Western Balkan Health Services Through Modernized Study Programmes and Human Resources Development)	Erasmus+ Capacity Building in the Field of Higher Education (Key Action 2: Cooperation for innovation and the exchange of good practices, Capacity-building in higher education)	Universiteti Shtetëror i Novi Pazarit, në Serbi	Periudha e aplikimit: 2016	Në proces
3	<b>QUASAR</b> (Quality Assured Fast-track Recognition of Foreign Higher Education Qualifications)	Erasmus+ Capacity Building in the Field of Higher Education (Key Action 2: Cooperation for innovation and the exchange of good practices, Capacity-building in higher education)	Universiteti i Splitit, në Kroaci	Periudha e aplikimit: 2016	Në proces
4	<b>Erasmus+</b> Inter-institutional Agreement for mobility of Students and Staff	Erasmus+ Key Action 1 - Erasmus Mundus Joint Master Degrees (Key Action 1: Learning Mobility of Individuals,	Universiteti i Saarlandit, në Gjermani	2016-2018	Në proces

		Erasmus Mundus Joint Master Degrees)			
5	Erasmus+ Inter-institutional Agreement for mobility of Students and Staff	Erasmus+ Key Action 1 - Erasmus Mundus Joint Master Degrees (Key Action 1: Learning Mobility of Individuals, Erasmus Mundus Joint Master Degrees)	Universiteti i Bolonjës, në Itali	2016-2018	Në proces
6	Erasmus+ Inter-institutional Agreement for mobility of Students and Staff	Erasmus+ Key Action 1 - Erasmus Mundus Joint Master Degrees (Key Action 1: Learning Mobility of Individuals, Erasmus Mundus Joint Master Degrees)	Universiteti i Kamerinos, në Itali	2016-2018	Në proces
7	ALBNANO	Horizon2020	INI-Novation GmbH, në Gjermani	Periudha e aplikimit: 2016	Në proces

Tabela 1.2 Projektet shkencore në rang universiteti

## 2. Aktivitetet shkencore në nivel fakulteti

Nr.	FAKULTETI	Konferenca kombëtare	Konferenca ndërkombëtare	Totale
1.	Fakulteti i Mjekësisë	8	4	12
2.	Fakulteti i Mjekësisë Dentare	3	3	6

Tabela 2.1 Konferencat shkencore të realizuara në rang fakulteti

### ➤ Fakulteti i Mjekësisë

Fakulteti i Mjekësisë ka organizuar dhjetëra kongrese dhe konferenca shkencore, si bashkëpunime me shoqata të ndryshme ndërkombëtare sipas specialiteteve. Gjithashtu, gjatë vitit 2016 janë organizuar të paktën katër konferenca studentore, si dhe aktivitete të tipit Forum, të cilat janë organizuar në disa shërbime/seksione. Këto veprimtari janë mbështetur nga Fakulteti i Mjekësisë dhe grupeve organizatore u është ofruar asistencë organizative e shkencore. Grupe të shumta pedagogësh kanë ndihmuar studentët, duke siguruar cilësi dhe garancinë e të dhënave shkencore të paraqitura. Në këto konferenca janë përfshirë disa qindra studentë të Fakultetit të Mjekësisë, si pjesëmarrës e prezantues, duke përfshirë këtu edhe ish-studentë të këtij fakulteti, që aktualisht studiojnë dhe punojnë në vende të tjera. Fokusi kryesor ishte klinik në specialitete si kirurgji, onkologji, neurokirurgji, ORL etj, por kishte edhe referime në fushën e stomatologjisë,

farmacisë dhe shëndetit publik.

Pothuajse të gjithë pedagogët e Fakultetit të Mjekësisë kanë marrë pjesë në veprimtari shkencore (kongrese, konferenca, workshop-e) nga më prestigjiozet e specialitetit të tyre. Disa njësi të fakultetit kanë marrë pjesë botime raportesh dhe broshurash, në bashkëpunim me institucione dhe organizata vendase dhe të huaja, si Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Shëndetit Publik, Organizata Botërore e Shëndetësisë etj.

<b>Nr.</b>	<b>Titulli i konferencës/kongresit</b>	<b>Data e zhvillimit</b>
<b>1</b>	Shoqata Shqiptare e Neurologjisë, Neurokirurgjisë dhe Neuroradiologjisë	04.02.2016
<b>2</b>	Konferenca e 6-të Kombëtare e Reumatologjisë	23.12.2016
<b>3</b>	Konferenca XX Kombëtare, Shoqata Shqiptare e Kardiologjisë	17.12.2016
<b>4</b>	Kongresi i Neuroshkencave Shqiptare	2 - 3.12.2016
<b>5</b>	Konferenca e Kombëtare e Shoqatës Shqiptare të Angjiologjisë dhe Kirurgjisë Vaskulare	19.11.2016
<b>6</b>	Konferenca e 24-t e Kirurgjikale Shqiptare	28 - 29.10.2016
<b>7</b>	Urdhri i Farmacistit të Shqipërisë, Ceremonia e 10-vjetorit të krijimit	27.10.2016
<b>8</b>	Shoqata Shqiptare e Infektivologjisë	19.11.2015

*Tabela 2.2 Konferencat shkencore kombëtare të Fakultetit të Mjekësisë*

<b>Nr.</b>	<b>Titulli i konferencës/kongresit</b>	<b>Data e zhvillimit</b>
<b>1</b>	24th Meeting of the Balkan Clinical Laboratory Federation and the 4th Albanian National Conference of Clinical Biochemistry and Laboratory Medicine (BCLF) 2016)	05 - 07/10/2016
<b>2</b>	3rd EUASSO (European Asian Society of Surgical Oncology Congress)	13 - 15.10.2016
<b>3</b>	16th National Conference of Pediatrics	14 - 15.10.2016
<b>4</b>	Symposium of Interventional Neuroradiology	16.07.2016

*Tabela 2.3 Konferencat shkencore ndërkombëtare të Fakultetit të Mjekësisë*

<b>Nr.</b>	<b>Emri i projektit</b>	<b>Fondi/Programi</b>	<b>Institucioni koordinator</b>	<b>Periudha e projektit</b>	<b>Statusi</b>
<b>1</b>	<b>EUSCREEN</b> (Implementation of cost-optimized childhood vision and hearing screening programmes in middle-income countries in Europe)	Horizon2020	Universiteti Erasmus i Roterdamit, në Hollandë	Aplikuar dhe fituar gjatë vitit 2016. Zbatimi 01.01. 2017 - 31.12.2020	Në proces
<b>2</b>	<b>DEEP</b> (DEferiprone Evaluation in Paediatrics)	FP7 / Horizon2020	Consorzio per Valutazioni Biologiche e Farmacologiche (CVBF), në Itali	01.01.2011 - 31.08.2016	I përfunduar
<b>3</b>	<b>GAPP</b> (GAbapentin in Paediatric Pain)	FP7 / Horizon2020	Consorzio per Valutazioni Biologiche e Farmacologiche (CVBF), në Itali	Qershor 2013 - Dhjetor 2018	Në proces
<b>4</b>	<b>MEDIGENE</b> (Genetic and environmental factors of insulin resistance syndrome and its long-term complications in immigrant Mediterranean populations)	FP7/ Horizon2020	Universiteti i Montpellesë I, në Francë	01.01.2012 - 31.07.2016	I përfunduar
<b>5</b>	<b>EMCDDA</b> Albania	European Monitoring Centre for Drugs and Drug Addiction (EMCDDA), within its European Union financed IPA project 2011/280-057	EMCDDA	2007-2017	Në proces

*Tabela 2.4 Projektet shkencore të Fakultetit të Mjekësisë*

▪ **Promovimi i titujve shkencorë**

Në vitin 2016 ka pasur një ecure normale të funksionimit të strukturave akademike në Fakultetin e Mjekësisë, duke siguruar promovimin e një numri të konsiderueshëm të stafit pedagogjik (kryesisht të brendshëm) të këtij fakulteti, ku: 56 pedagogë fituan titullin “Profesor i Asociuar” dhe 25 pedagogë fituan titullin “Profesor”. Fakulteti i Mjekësisë mbetet një prej fakulteteve me numrin më të lartë të pedagogëve të kategorisë “Profesor” në sistemin tonë universitar.

▪ **Edukimi në vazhdim**

Fakulteti i Mjekësisë vazhdon të luajë një rol thelbësor për aktivitetin e Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim, pasi pedagogët e këtij fakulteti janë vlerësuesit e të gjitha aktiviteteve në rang vendi. Departamentet e fakultetit kanë pasur rolin e tyre të rëndësishëm në procesin e ricertifikimit, sipas parashikimeve ligjore, për llogari të Ministrisë së Shëndetësisë, si një aktivitet i ri, i realizuar për herë të parë gjatë vitit 2016. Provimet e ricertifikimit ishin vetëm faza e fundit e një pune parapërgatitore në hartimin e programeve të provimit të realizuar pranë departamenteve të Fakultetit të Mjekësisë.

➤ **Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike**

Gjatë vitit 2016, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike është angazhuar në mënyre aktive dhe cilësore në veprimtaritë shkencore, sipas një plani mësimor të miratuar në fillim të vitit, por nuk përjashtohen rastet kur stafi pedagogjik është përfshirë në aktivitete shkencore të çastit. Sipas këtij plani, punonjësit mësimorë janë angazhuar në një aktivitet të gjerë shkencor, ku përfshihen punime e referime shkencore, botime të teksteve mësimore, mbrojtje të titujve shkencorë etj. Vlen për t’u theksuar se në këtë veprimtari shkencore, çdo pedagog është orientuar në fushat e profilizimit të tij si mësimdhënës e kërkues shkencor, duke lidhur në këtë mënyrë kërkimin shkencor me mësimdhënien që realizon në lëndët e tij.


Kërkimi shkencor është i lidhur me procesin mësimor. Linjat e kërkimit janë të orientuara drejt çështjeve shkencore që trajtohen në programet mësimore, duke bërë të mundur edhe pasurimin e leksioneve me përvojën e pedagogëve si studiues. Nga analiza e bërë në departamente u evidentua se nuk ka pasur punë shkencore të organizuar sipas departamenteve dhe në bashkëpunim me njeri-tjetrin. Ajo është kryer në mënyrë individuale dhe, duke iu referuar tabelës përmbledhëse të aktivitetit shkencor të pedagogëve, vihet re se numri më i madh i botimeve është kryer nga pedagogët të cilët janë në proces doktrate.

Nr.	Aktiviteti	Departamenti i Lëndëve Klinike dhe Infermieristikës së Përgjithshme, Infermierisë në Sëmundje të Brendshme, Pediatri	Departamenti i Lëndëve Paraklinike	Departamenti i Diagnostikës, Rehabilitimit Shëndetësor dhe Infermieristikës në Kirurgji, Infermieristikës në Obstetrikë-Gjinekologji
-----	------------	--	------------------------------------	--



1	Monografi shkencore (si autor dhe me bashkëautorë) brenda dhe jashtë vendit	2	6	1
2	Artikuj në revista dhe periodike shkencorë brenda vendit (shqip dhe në gjuhë të huaj)	30	9	26
3	Artikuj dhe periodikë në revista shkencore jashtë vendit	42	20	63
4	Pjesëmarrje me referim në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca)	31	18	58
5	Pjesëmarrje me referim në aktivitete shkencore ndërkombëtare (seminare, kongrese, konferenca)	73	32	110
6	Pjesëmarrje si moderator në aktivitete shkencore ndërkombëtare (seminare, kongrese, konferenca)	1	0	2
7	Pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare	0	1	0

Tabela 2.5 Aktiviteti shkencor i realizuar në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike




Grafiku 2.1 Aktiviteti shkencor i realizuar në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike

## ➤ Fakulteti i Mjekësisë Dentare

Puna kërkimore-shkencore në Fakultetin e Mjekësisë Dentare është realizuar përmes konferencave shkencore në nivel fakulteti dhe punës individuale të lektorëve.

Nr.	Departamenti	Doktorata	Oponenca	Anëtar në komisione për vlerësimin e titujve	Recensentë botimesh	Projekte të ndryshme	Referime në konferenca brenda vendit	Referime në konferenca jashtë vendit	Artikuj shkencorë brenda vendit	Artikuj shkencorë jashtë vendit	Libra/Monografi shkencore	Udhëheqje temash diplome
1	Departamenti i Terapisë Stomatologjike	3	4	0	0	0	15	19	8	4	1	19
2	Departamenti i Ortopedisë Stomatologjike	2	5	4	1	0	15	19	4	3	0	10
3	Departamenti i Kirurgjisë OMF dhe Paraklinike	4	5	0	0	0	10	5	7	5	0	5

Tabela 2.6 Puna kërkimore-shkencore në Fakultetin e Mjekësisë Dentare



Grafiku 2.2 Puna kërkimore-shkencore në Fakultetin e Mjekësisë Dentare

Në analizat e trajtuara nga 3 (tri) departamentet, aktiviteti kërkimor-shkencor i stafit akademik është në nivele të kënaqshme. Mesatarisht çdo punonjës akademik i Fakultetit të Mjekësisë Dentare ka marrë pjesë në 2,5 konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, numri i publikimeve është në nivelin e 2,5 publikime për çdo pedagog, në revista brenda dhe jashtë vendit, me dhe pa impakt faktor, në *Revistën Stomatologjike Shqiptare*, organ i FMD-së, dhe në Buletinin e Shkencave Mjekësore, organ i UMT-së. Këto janë tregues të angazhimit të vazhdueshëm të stafit të Fakultetit të Mjekësisë Dentare në fushën kërkimore-shkencore. Pedagogë të departamenteve të Fakultetit të Mjekësisë Dentare, në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Edukimit në Vazhdim, kanë realizuar me sukses një sërë leksionesh në kuadër të edukimit në vazhdim (CME) të mjekëve stomatologë në mbarë vendin. Gjithashtu, pedagogët kanë bashkëpunuar me Agjencinë Kombëtare të Provimeve për procesin e Provimit të Shtetit në profesionet e rregulluara. Po kështu, ka pasur bashkëpunime me Agjencinë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë në procesin e akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë. Gjatë vitit 2016 janë zhvilluar një sërë aktiviteteve shkencore, në të cilat ka pasur një pjesëmarrje të gjerë, aktive dhe pasive, të stafit akademik dhe të studentëve, kryesisht të viteve të larta.

<b>Nr.</b>	<b>Aktiviteti</b>	<b>Datat</b>
<b>1</b>	Revista Stomatologjike Shqiptare me ISSN 2308-5290, u miratuar këtë vit nga Senati Akademik i UMT-së si revistë shkencore dhe organ i Fakultetit të Mjekësisë Dentare	2016
<b>2</b>	Konferenca e 22-të Kombëtare Dentare	18 - 19.11.2016
<b>3</b>	Simpoziumi i 3-të Ortodontik Shqiptar	22.10.2016
<b>4</b>	Fillimi i bisedimeve për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Fakultetit të Mjekësisë Dentare dhe Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës	Nëntor 2016
<b>5</b>	Simpoziumi i Edukimit në Vazhdim, Strugë, në bashkëpunim me pedagogë të FMD-së	Tetor 2016
<b>6</b>	Marrëveshje bashkëpunimi me KSU-në	Shtator 2016
<b>7</b>	Aktivitet studentor mbi higjienën dentare, organizuar nga ADSA-ja dhe FMD-ja	Gusht 2016
<b>8</b>	Kongresi i 21-të ndërkombëtar i BASS-it në Banja Luka, Bosnje Herzegovinë	Maj 2016
<b>9</b>	Prej 10 vjetësh, 3 anëtarë të stafit akademik janë anëtarë të Kryesisë së BASS-it (Shoqata Stomatologjike Ballkanike), ndërkohë që	Maj 2016

	pjesëmarrja e pedagogëve dhe e profesionistëve shqiptarë në Kongreset Ballkanike, prej vitesh ka qenë dhe është masive	
<b>10</b>	Kongresi i 6-të Ndërkombëtar i Shoqatës së Dentistëve Shqiptarë të Maqedonisë, i mbajtur në Strugë, Maqedoni	Maj 2016
<b>11</b>	Konferencëe studentëve, e organizuar nga Shoqata e Studentëve Stomatologë, në bashkëpunim me Fakultetin e Mjekësisë Dentare	19.03.2016

*Tabela 2.7 Aktiviteti shkencor në Fakultetin e Mjekësisë Dentare*

<b>Nr.</b>	<b>Titulli i konferencës/kongresit</b>	<b>Data e zhvillimit</b>
<b>1</b>	Konferenca e 22-të Kombëtare Dentare	18 - 19.11.2016
<b>2</b>	Simpoziumi i 3-të Ortodontik Shqiptar	22.10.2016
<b>3</b>	Konferenca e studentëve, e organizuar nga Shoqata e Studentëve Stomatologë, në bashkëpunim me Fakultetin e Mjekësisë Dentare	19.03.2016

*Tabela 2.8 Konferencat shkencore kombëtare të Fakultetit të Mjekësisë Dentare*

<b>Nr.</b>	<b>Titulli i konferencës/kongresit</b>	<b>Data e zhvillimit</b>
<b>1</b>		
<b>2</b>	Kongresi i 21-të Ndërkombëtar i BASS-it, në Banja Luka, Bosnje Hercegovinë	Maj 2016
<b>3</b>	Kongresi i 6-të Ndërkombëtar i Shoqatës së Dentistëve Shqiptarë të Maqedonisë, i mbajtur në Strugë, Maqedoni	Maj 2016

*Tabela 2.9 Konferencat shkencore ndërkombëtare të Fakultetit të Mjekësisë Dentare*

<b>Nr.</b>	<b>Revista</b>	<b>Vëllimi</b>	<b>Numri</b>	<b>Muaji</b>	<b>Numri i artikujve</b>
<b>1</b>	<b>AJMHS</b>	Vëllimi 46	Numri 1	Prill 2015	12 artikuj
<b>2</b>	<b>AJMHS</b>	Vëllimi 46	Numri 2	Gusht 2015	10 artikuj
<b>3</b>	<b>AJMHS</b>	Vëllimi 46	Numri 3 (+ suplement)	Dhjetor 2015	12 artikuj
<b>4</b>	<b>AJMHS</b>	Vëllimi 47	Numri 1	Prill 2016	7 artikuj


*Tabela 2.10 Publikimet shkencore të vitit 2016 në revistën universitare të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë “Albanian Journal of Medical and Health Sciences” (AJMHS) (ISSN 2412-6373 dhe E-ISSN 2413-3892)”*

Nr.	Revista	Vëllimi	Numri	Muaji	Numri i artikujve
1	Revista Stomatologjike Shqiptare	Vëllimi 13	Numri 1	Qershor 2015	8 artikuj
2	Revista Stomatologjike Shqiptare	Vëllimi 13	Numri 2	Dhjetor 2015	7 artikuj

Tabela 2.11 Publikimet shkencore të vitit 2016 në revistën e Fakultetit të Mjekësisë Dentare “Revista Stomatologjike Shqiptare”

Nr.	Revista	Numri	Viti	Numri i artikujve
1	Mjekësia Bashkëkohore	Numri 16	2015	78 artikuj
2	Mjekësia Bashkëkohore	Numri 16	2016	65 artikuj

Tabela 2.12 Publikimet shkencore të vitit 2016 në revistën e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike “Mjekësia Bashkëkohore”



Grafiku 2.3 Publikimet shkencore të Fakultetit të Mjekësisë Dentare në revistat shkencore

### 3. Marrëveshjet e nënshkruara në vitin 2016

Gjatë vitit 2016, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, ka nënshkruar mjaft marrëveshje bashkëpunimi me universitete dhe institucione të ndryshme evropiane, në drejtim të zhvillimit të aktiviteteve të

shumta shkencore dhe përfshirjes në projekte të reja.

Nr.	Institucioni	Data	Lloji i marrëveshjes	Fusha e bashkëpunimit
1	Instituti i Shkencave të Informacionit të Mariborit, IZUM (Sloveni)	12.04.2016	Aneks-marrëveshje për përdorim të infrastrukturave	Instalim dhe përdorim i platformës së katalogimit online COBISS.AL për bibliotekën e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë

Tabela 3.1 Marrëveshje me qendra dhe institucione të ndryshme

Nr.	Universiteti	Data	Lloji i marrëveshjes	Fusha e bashkëpunimit
1	Universiteti i Akuilas (Itali)	22.04.2016	Marrëveshje kuadër	Bashkëpunim kuadër në shkëmbime dhe projekte të përbashkëta
2	Universiteti i Barit "Aldo Moro" (Itali)	21.06.2016	Marrëveshje kuadër	Bashkëpunim kuadër në shkëmbime dhe projekte të përbashkëta
3	Universiteti i Tiranës (Shqipëri)	01.08.2016	Marrëveshje kuadër	Bashkëpunim kuadër në shkëmbime dhe projekte të përbashkëta
4	Charles University (Republika Çeke)	06.10.2016	Marrëveshje kuadër	Bashkëpunim kuadër në shkëmbime dhe projekte të përbashkëta

Tabela 3.2 Marrëveshje me institucione të tjera të arsimit të lartë

Nr.	Erasmus+	Data	Lloji i marrëveshjes	Universitetet
1	<i>Erasmus+</i> Inter-institutional Agreement for mobility of Students and Staff	04.05.2016 dhe 09.12.2016	Marrëveshje Erasmus+ Key Action 1 - Erasmus Mundus Joint Master Degrees (Key Action 1: Learning Mobility of Individuals, Erasmus	Universiteti i Saarlandit, në Gjermani, dhe Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

			Mundus Joint Master Degrees)	
2	<i>Erasmus+</i> Inter-institutional Agreement for mobility of Students and Staff	25.10.2016	Marrëveshje Erasmus+ Key Action 1 - Erasmus Mundus Joint Master Degrees (Key Action 1: Learning Mobility of Individuals, Erasmus Mundus Joint Master Degrees)	Universiteti i Kamerinos, në Itali, dhe Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

Tabela 3.3 Marrëveshje me institucionet e tjera të arsimit të lartë në kuadër të programit evropian “Erasmus+”

#### 4. Pjesëmarrja në rrjetet akademike

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është partner (Target Group 1) në projektin Evropian “Erasmus Mundus – Western Balkan (ERAWEB II)”. Projekti ERAWEB II mbështet shkëmbimet mes universiteteve të rrjetit për studentët në ciklet e studimit *bachelor, master, doktoratë dhe post-doktoratë*, si edhe për stafin akademik. Gjithashtu, ky projekt ofron mundësinë për të kryer kërkime shkencore në fushat kërkimore të caktuara, të cilat mund të zhvillohen në një ndër universitetet e rrjetit për një periudhë të caktuar. Projekti ERAWEB II koordinohet nga Universiteti Erasmus i Roterdamit, në Holandë, dhe përfshin universitete prestigjioze, si Universiteti Ludwig-Maximilians-München (Gjermani), Universiteti Katolik “Sacro Cuore” (Itali), Universiteti për Shkencat e Shëndetit, Informatikës Mjekësore dhe Teknologjisë (Austri), Universiteti i Leuvenit (Belgjikë) dhe Universiteti i Torinos (Itali). ERAWEB II shpalli thirrjen për aplikime në periudhën janar–mars 2016. Në kuadër të thirrjes së vitit 2016, aplikuan rreth 30% e studentëve të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë. Nga studentët fitues, 6 ishin në kuadrin e shkëmbimit studentor dhe 4 në kuadrin e studimeve kërkimore-shkencore në universitetet e rrjetit. Aktiviteti akademik dhe shkencor është aktualisht në zhvillim dhe periudha e shkëmbimeve të kësaj thirrjeje përfundon në muajin korrik 2017.

Gjithashtu, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është anëtar me të drejta të plota në rrjetin universitar “Balkan Universities Assosiation (BUA)” dhe në rrjetin e njohur të Universiteteve Evropiane, që ofrojnë programe të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” në fushat e mjekësisë dhe “Organisation for PhD Education in Biomedicine and Health Sciences in the European System (ORPHEUS)”. Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është pjesë e rrjetit universitar në fushën e mjekësisë pediatrike (CIII-AT-0042-12-1617)”, që vepron nën Programin “Central European

## **5. Njohjet ndërkombëtare institucionale të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë**

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është i njohur nga “*Federata Botërore për Arsimin Mjekësor (WFME)*” dhe “*Fondacioni për Përparimin Ndërkombëtar të Arsimit dhe Kërkimit Mjekësor (FAIMER) (FAIMER SCHOOL ID: F0001900)*”.

Gjithashtu, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është i njohur nga institucioni amerikan përgjegjës për njohjen e diplomave të fushave të mjekësisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Kanada “*Educational Commission for Foreign Medical Graduates (ECFMG)*”; *CGFNS International*, përgjegjës për njohjen e diplomave të fushave të infermierisë dhe shkencave mjekësore teknike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës; Institucioni *World Education Services (WES)*, përgjegjës për njohjen e diplomave të përgjithshme në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Kanada; *Educational Credential Evaluators (ECE)*, përgjegjës për njohjen e diplomave, kryesisht në fushat e Farmacisë dhe Shëndetit Publik, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës; *Foreign Credentialing Commission on Physical Therapy (FCCPT)*, përgjegjës për njohjen e diplomave në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kryesisht në fushën e Fizioterapisë; *National Nursing Assessment Service (NNAS)* dhe *Canadian Registration for Internationally Educated Nurses (IENs)*, përgjegjëse për njohjen e diplomave, kryesisht në fushën e infermierisë në Kanada; *Josef Silny & Associates*, përgjegjës për njohjen e diplomave të përgjithshme në Shtetet e Bashkuara të Amerikës; *Nursing & Midwifery Council (NMC)*, përgjegjës për njohjen e diplomave të përgjithshme në Britaninë e Madhe; *Zentralen Auslands-und Fachvermittlung (ZAV)*, përgjegjës për njohjen e diplomave të fushave mjekësore në Gjermani.



### III. VEPRIMTARIA FINANCIARE

Veprimtaria financiare (realizimi faktik), për periudhën 01 janar-31 dhjetor 2016, për Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, është 755 362 589 lekë, i financuar në vlerën 476 678 285 lekë nga buxheti i shtetit për vitin 2016 dhe 278 684 304 lekë nga të ardhurat e institucionit. Sa më sipër, konstatojmë se aktiviteti financiar është financuar në masën 63.13% nga buxheti i shtetit dhe 36.89% nga të ardhurat e institucionit.

#### *Shpenzime korente*

Për periudhën janar-31 dhjetor 2016, shpenzimet korente (shpenzime paga + sigurime shoqërore + shpenzime operative + bursa + shpenzime për transferta tek individët) janë në vlerën 755 362 589 lekë. Ky zë shpenzimesh, krahasuar me vitin 2015, ka një rritje prej 46 703 225 lekësh. Financimi i tyre në vitin 2016 është realizuar në vlerën 476 678 285 lekë ose 63.11% nga buxheti i shtetit dhe 278 684 304 lekë ose 36.89% nga të ardhurat e institucionit.

1. Realizimi faktik për periudhën janar-31 dhjetor 2016, në zërin “*Shpenzime për paga*”, është 537 153 104 lekë, ose 71.11% e totalit të shpenzimeve faktike vjetore. Shpenzimet faktike për personelin janë financuar në vlerën 393 172 004 lekë ose 73.2% nga buxheti i shtetit dhe 143 981 100 lekë ose 26.8% nga të ardhurat.
2. Realizimi faktik për periudhën janar-31 dhjetor 2016, në zërin “*Shpenzime për sigurime shoqërore*” është në vlerën 71 372 743 lekë ose 9.45 % të totalit të shpenzimeve faktike vjetore. Ky zë është financuar në vlerën 62 132 823 lekë ose në masën 87% nga buxheti dhe 9 239 920 lekë ose 13% nga të ardhurat tona.
3. Realizimi faktik për periudhën 01.01.2016-31.12.2016 në zërin “*Shpenzime operative*” është 90 761 516 lekë dhe zë 12% të totalit të shpenzimeve faktike vjetore. Financimi i shpenzimeve operative vjetore është realizuar në masën 100% nga të ardhurat.
4. Shpenzimet faktike për periudhën 01.01.2016-31.12.2016 në zërin “*Bursa dhe transferta të tjera*” janë 23 657 992 lekë dhe zënë 3.13% të totalit të shpenzimeve. Financimi i tyre është bërë në masën 21 373 458 lekë ose 90.3% nga buxheti i shtetit dhe 2 284 534 lekë ose 9.7% nga të ardhurat.
5. Shpenzimet për investime “*Shpenzime për rritjen e aktiveve të trupëzuara*” janë në vlerën 32 417 234 lekë ose 4.3 % të totalit të shpenzimeve vjetore. Financimi i tyre është bërë në masën

100% nga të ardhurat e institucionit.

### ***Fondet buxhetore të planifikuara***

Për Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin 2016, fondi i planifikuar nga buxheti i shtetit për financimin e aktivitetit financiar është 496 952 000 lekë, i përbërë nga 458 782 000 lekë nga granti (financim i dhënë në formën e transfertës së pakushtëzuar) për paga + sigurime dhe 38 170 000 lekë për bursa;

Granti buxhetor për vitin 2016 është i detajuar sipas planeve buxhetore si më poshtë:

- Plani vjetor buxhetor në zërin “*Shpenzime për paga*” është 396 289 860 lekë, ose 79.74% e fondeve buxhetore vjetore.
- Plani vjetor buxhetor në zërin “*Shpenzime për kontribute për sigurime shoqërore*” është 62 492 140 lekë, ose 12.6% e fondeve buxhetore.
- Plani vjetor buxhetor në zërin “*Shpenzime për bursa*” është 38 170 000 lekë, ose 7.7% e fondeve buxhetore.

### **1. Realizimi faktik vjetor i shpenzimeve me financim nga fondet buxhetore**

Totali i shpenzimeve buxhetore faktike të realizuara për periudhën 01.01.2016 –31.12.2016 është 476 678 285 lekë. Realizimi i shpenzimeve të planifikuara me burim financimi nga buxheti i vitit 2016 është në masën 95.92% e planit, përkatësisht sipas zërave të mëposhtëm:

#### ***Shpenzime buxhetore faktike në zërin “Shpenzime për paga”***

Shpenzimet vjetore faktike për paga janë në vlerën 393 172 004 lekë, ose 99.36% e planit buxhetor vjetor në zërin “*Shpenzime paga*” dhe zënë 82.5% të shpenzimeve totale vjetore me financim nga buxheti i shtetit. Në këtë zë janë përfshirë shpenzimet për paga, për periudhën dhjetor 2015-tetor 2016, për 413 punonjës buxhetorë. Shpenzimet për paga për muajin nëntor 2016 janë financuar pjesërisht nga të ardhurat e institucionit. Nuk janë përfshirë pagat e muajit dhjetor 2016, të cilat likujdohen në janar të vitit 2017.

Fondi buxhetor i planifikuar për shpenzime për paga është përdorur vetëm për financimin e pagave për 413 punonjësit buxhetorë në periudhën janar-tetor 2016. Shpenzimet e tjera për personelin, si shpenzime për orë mbi normë, shpenzime për lektorë të ftuar, apo personel me kontratë të përkohshme, janë financuar 100% nga të ardhurat e institucionit.

#### ***Shpenzime buxhetore në zërin “Shpenzime për kontribute për sigurime shoqërore”***

Shpenzimet vjetore buxhetore janë realizuar në masën 62 132 823 lekë ose 99.43% e planit buxhetor dhe zënë 13% të totalit të shpenzimeve vjetore buxhetore.

Në këtë fond janë përfshirë kontributet për sigurimet shoqërore për periudhën dhjetor 2015-tetor 2016. Shpenzimet për sigurime shoqërore për periudhën nëntor 2016 janë financuar nga të ardhurat e vetë institucionit.

### ***Shpenzime buxhetore në zërin “Shpenzime për bursa & të tjera transferta tek individë”***

Këto shpenzime janë realizuar në vlerën prej 21 373 458 lekësh, ose 55.12% e planit në këtë zë. Ato zënë 4.5% të totalit të shpenzimeve buxhetore për periudhën 01.01.2016-31.12.2016. Në këtë vlerë janë përfshirë shpenzimet për bursa për studentët e të gjitha viteve, për të gjitha fakultetet, për periudhën janar-qershor 2016. Për vitin akademik 2015-2016 janë shpërndarë bursa për 402 studentë, të cilët plotësojnë kriteret për t’u trajtuar me bursë.

## **2. Realizimi faktik vjetor i shpenzimeve me financim nga të ardhurat**

Financimi i aktivitetit financiar të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, nga të ardhurat e realizuara nga vetë universiteti, për periudhën janar-31 dhjetor 2016, është në vlerën 278 684 304 lekë, të përdorura si më poshtë vijon:

### ***Shpenzime nga të ardhurat në zërin “Shpenzime për paga”***

Këto shpenzime janë në vlerën 143 981 100 lekë ose 51.66% e shpenzimeve me financim nga të ardhurat. Ky artikull përfshin:

- Shpenzimet për paga për personelin me kontratë të përkohshme (të financuara 100% nga të ardhurat tona) janë 40 412 367 lekë ose 28.1% e totalit për shpenzime për paga dhe 20.61% e totalit të shpenzimeve për paga të planifikuara nga të ardhurat.
- Shpenzimet për pagat e punonjësve buxhetorë për vitin 2016 janë në vlerën 393 172 004 lekë.
- Shpenzimet për stafin akademik të jashtëm, të ftuar dhe mbingarkesat (të financuara 100% nga të ardhurat tona) janë në total 87 564 571 lekë, ose 60.82% e totalit të zërit “Shpenzime për paga nga të ardhurat” ose 44.67 % e totalit të shpenzimeve vjetore për paga të planifikuara nga të ardhurat. Për vitin akademik 2015-2016 janë paguar 770 pedagogë të brendshëm dhe pedagogë me kohë të pjesshme, të cilët kanë realizuar 142 378.35 orë mësimore.

### ***Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore***

Për vitin 2016, financimet nga të ardhurat janë në vlerën 9 239 920 lekë dhe zënë 3.32% të totalit vjetor të realizuara nga të ardhurat. Në këtë zë janë përfshirë shpenzimet për të likuiduar detyrimet për sigurime shoqërore për punonjësit me kontratë të përkohshme dhe pjesërisht sigurimet e muajit nëntor 2016, pasi në mungesë të fondeve buxhetore, për të financuar këto shpenzime janë përdorur të ardhurat.

### ***Shpenzimet operative***

Shpenzimet operative të financuara nga të ardhurat janë në vlerën 90 761 516 lekë, ose 32.57% e financimit total vjetor nga të ardhurat e vitit 2016.

Ato janë përdorur si më poshtë:

- Nënartikulli 6020 “*Shpenzime për blerje materiale zyre, si letër, kanceleri, toner, materiale pastrimi etj.*” në vlerën 14 665 374 lekë, ose 16.16 % e tyre.
- Nënartikulli 6021 “*Shpenzime për blerje të tjera materiale*” në vlerën 2 975 302 lekë, ose 3.28% e tyre.
- Nënartikulli 6022 “*Shpenzime për shërbime*” është në vlerën 34 046 181 lekë, ose 37.51% e shpenzimeve operative të financuara nga të ardhurat. Peshën kryesore në këtë artikull (pothuajse 43.4%) e zënë “*Shpenzime për të tretë*” (energji + ujë + telefon + shërbim postar) dhe rreth 56.6% janë shpenzime për ruajtje me roje civile.
- Nënartikulli 6024 “*Shpenzime për udhëtime brenda dhe jashtë vendit*”, me financim nga të ardhurat, është në vlerën 587 591 lekë dhe zë 0.65% të shpenzimeve operative nga të ardhurat.
- Nënartikulli 6025 “*Shpenzime për mirëmbajtje*”, me financim nga të ardhurat, është në vlerën 2 532 867 lekë dhe zë 2.79 % të shpenzimeve operative nga të ardhurat.
- Nënartikulli 6026 “*Shpenzime qiraje*” është në vlerën 1 005 510 lekë, ose 1.11% të shpenzimeve operative nga të ardhurat.
- Nënartikulli 6029 “*Shpenzime të tjera*” është në vlerën 34 948 691 lekë, ose 38.51 % të shpenzimeve operative nga të ardhurat.

### ***Shpenzime për financimin e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara***

Shpenzimet për aktivet e qëndrueshme të trupëzuara me burim financimi nga të ardhurat, gjatë

periudhës janar-31 dhjetor 2016, janë në vlerën 32 417 234 lekë dhe zënë 11.63% të të ardhurave të përdorura.

### **3. Realizimi i të ardhurave**

Të ardhurat e realizuara gjatë periudhës janar-31 dhjetor 2016 janë në vlerën rreth 371 070 262 lekë, ku:

- të ardhurat nga tarifat e shkollimit (të gjitha programet dhe ciklet e studimit) janë 356 563 247 lekë, ose 96.1% e totalit të të ardhurave;
- të ardhurat e arkëtuara nga tarifat e regjistrimit dhe vërtetimet janë 8 271 262 lekë ose 2.23% e të ardhurave të realizuara;
- të ardhurat nga tarifat administrative, programet e studimit, tarifat për trajnime për pjesëmarrje në konferenca etj., janë 6 019 753 lekë, ose 1.62% e të ardhurave;
- të ardhurat nga qiratë janë 216 000 lekë.

Bazuar në Ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 “*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë*”, të ndryshuar, Ligjin nr. 80/2015 “*Për arsimin e lartë dhe institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*”, si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave “*Udhëzim për zbatimin e vitit 2016*”, të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2016 dhe të papërdorura, institucioni ynë do t’i trashëgojë në vitin buxhetor pasardhës. Të ardhura të trashëguara në vitin 2017 janë rreth 359 258 943 lekë. Në qoftë se do t’i referohemi shpenzimeve faktike dhe numrit mesatar të studentëve, rezulton së për vitin 2016 kostoja mesatare për student është 32 199 lekë. Në përfundim, një analizë më e hollësishme në nivel degësh dhe fakultetesh për aktivitetin akademik, shkencor dhe financiar, gjendet në analizat e realizuara nga njësitë kryesore.